

Hapet thirrja për aplikim për 2 (dy) bursa në kuadër të Programit Erasmus+ për staf akademik me kohë të plotë për mësimdhënie pranë Universitetit të Romës “Foro Italico”

Në kuadër të programit Erasmus + hapet thirrja për aplikim për 2 (dy) bursa për mobilitete pranë Universitetit të Romës “Foro Italico” për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Sporteve të Tiranës për mësimdhënie,

Mobiliteti përfshin:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie nga të gjitha njësitë kryesore të UST-së.

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 5 ditë + 2 ditë udhëtim

Bursa përfshin:

- Kompensimin ditor
- Koston e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës). Për të përcaktuar distancën, klikoni në linkun e mëposhtëm:
http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Për t’u njohur me katalogun e programeve të studimit që ofron Universiteti i Romës “Foro Italico” klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://www.uniroma4.it/index.php/didattica/corsi-di-studio/>

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. *Curriculum Vitae në gjuhën Angleze në formatin Europass;*
2. *Fotokopje e pasaportës;*
3. *Letër motivimi në gjuhën Angleze;*
4. *Certifikata që vërteton njohuritë e gjuhës Angleze/Italiane;*
5. *Plani i Mobilitetit.*

Plani i mobilitetit

Për të shkarkuar formatin e planit të mobilitetit klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://ust.edu.al/erasmus-2/>

Plani i mobilitetit për mësimdhënie është një document në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies.

Ky dokument firmoset vetem nga aplikanti në momentin e aplikimit.

Afati i fundit për aplikim: 25.04.2024

Dokumentet duhen dorëzuar në Zyrën e Protokollit në Rektoratit e Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe të skanuara në adresë: erasmus@ust.edu.al

Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e protokollit, duhet të shoqërohet me formularin e aplikimit që përmban të dhënat për çdo aplikant dhe duhet të firmoset nga ky i fundit.

Për të shkarkuar formularin klikoni në linkun e mëposht:

<https://ust.edu.al/erasmus-2/>